



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

VENDIM

Nr. 2, datë 15.02.2019

**PËR
PROCEDURËN E SHORTIT TË CAKTIMIT TË RELATORËVE PËR
POZICIONET VAKANTE NË ÇDO INSTITUCION¹**

Në mbështetje të pikës 2 dhe 3 të nenit 228 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

VENDOSI :

I. Dispozita të përgjithshme

1. Ky vendim përcakton rregulla më të hollësishme lidhur me procedurën e shortit për caktimin e relatorëve që ngarkohen sipas ligjit me shqyrtimin dhe verifikimin e dokumentacionit të depozituar nga kandidatët, përgatitjen e projektakteve të verifikimit, vlerësimit dhe të renditjes së tyre për pozicionet vakante në çdo institucion, në respektim të parimeve të transparencës, gjurmueshmërisë dhe monitorimit të procesit.

2. Relatorët përkatës për pozicionet vakante të shpallura nga çdo institucion që ka vënë në lëvizje Këshillin e Emërimeve në Drejtësi, caktohen përmes shortit elektronik, ndërmjet anëtarëve të këtij Këshilli.

3. Në rast se sistemi i administrimit të çështjeve të Gjykatës së Lartë nuk përmbush kushtet për realizimin e shortit në mënyrë elektronike, procedura e shortit zhvillohet në mënyrë manuale.

II. Përgatitja dhe njoftimet për procedurën e caktimit të relatorëve përmes shortit elektronik

4. Menjëherë pas mbledhjes së parë të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi të zgjedhur për vitin kalendarik, për përgatitjen dhe realizimin e procedurave të caktimit përmes shortit elektronik të relatorëve për pozicionet vakante në çdo institucion, Kryetari i Këshillit i njofton Kryetarit të Gjykatës së Lartë listën e anëtarëve dhe anëtarëve zëvendësues për regjistrimin të tyre në sistemin e administrimit të çështjeve të Gjykatës së Lartë.

¹ Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 19, date 19 Shkurt 2019
http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2019/PDF-2019/19-2019.pdf

5. Dita dhe ora e zhvillimit të procedurës së shortit elektronik për caktimin e relatorëve për pozicionet vakante në çdo institucion caktohet jo më vonë se 5 ditë nga dita e publikimit të listës së kandidatëve për pozicionin vakant në Gjykatën Kushtetuese nga subjektet që vënë në lëvizje Këshillin e Emërimeve në Drejtësi ose nga ajo e publikimit të listës së kandidatëve për pozicionin vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë nga ana e këtij Këshilli.

6. Kryetari i Këshillit njofton anëtarët dhe anëtarët zëvendësues për datën dhe orën e caktuar për zhvillimin e shortit elektronik. Së bashku me njoftimin, u dërgohet për tu njohur edhe lista e kandidatëve për pozicionet vakante dhe jetëshkrimet e tyre, për të vlerësuar gjendjen e mundshme të papajtueshmërisë, konfliktit të interesit dhe pengesës ligjore.

7. Njëkohësisht, për datën dhe orën e caktuar për zhvillimin e shortit elektronik, njoftohen për të marrë pjesë si vëzhgues edhe Avokati i Popullit, Presidenti i Republikës, Kryetari i Kuvendit dhe Komisioni i Përhershëm për çështjet ligjore në Kuvend. Së bashku me njoftimin, u dërgohet për tu njohur edhe lista e kandidatëve për pozicionet vakante dhe jetëshkrimet e tyre, për të vlerësuar gjendjen e mundshme të papajtueshmërisë, konfliktit të interesit dhe pengesës ligjore.

8. Njoftimi për datën dhe orën e caktuar për zhvillimin e shortit elektronik për caktimin e relatorit për pozicionet vakante në çdo institucion, i dërgohet menjëherë Kryetarit dhe Kancelarit të Gjykatës së Lartë për të bashkërenduar punën në përgatitjen dhe realizimin e kësaj procedure sipas ligjit.

9. Dita, ora dhe vendi i zhvillimit të shortit elektronik për caktimin e relatorëve për pozicionet vakante në çdo institucion publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë.

III. Caktimi i relatorëve përmes shortit elektronik

10. Në zhvillimin e procedurës së shortit elektronik për caktimin e relatorëve për pozicionet vakante në çdo institucion marrin pjesë anëtarët dhe anëtarët zëvendësues të Këshillit.

11. Në zhvillimin e procedurës së shortit elektronik marrin pjesë si vëzhgues Avokati i Popullit ose një përfaqësues i caktuar prej tij/saj, përfaqësuesi i autorizuar i Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit dhe dy deputetë anëtarë të komisionit të përhershëm përgjegjës për çështjet ligjore në Kuvend. Mosparaqitja e secilit prej tyre nuk përbën shkak për pezullimin e procedurës së zhvillimit të shortit.

12. Në realizimin e procedurës së shortit elektronik, Këshilli angazhon personelin administrativ të Gjykatës së Lartë që është i caktuar me funksione ndihmëse dhe mbështetëse për mbledhjet dhe veprimtaritë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

13. Kancelari dhe përgjegjësi i sektorit IT të Gjykatës së Lartë janë të pranishëm dhe mbështesin Këshillin për çdo nevojë në zhvillimin e procedurës së shortit elektronik. Nëse e vlerëson, i pranishëm në këtë procedurë shorti është edhe Kryetari i Gjykatës së Lartë.

14. Në ditën dhe orën e caktuar, në ambientin e posaçëm të Gjykatës së Lartë të caktuar për këtë qëllim, në praninë e atyre anëtarëve të Këshillit si edhe të përfaqësuesve të Avokatit të Popullit dhe subjekteve të treguar në pikën 5 më sipër që janë paraqitur, Kryetari i Këshillit deklaron fillimin e procedurave për zhvillimin e shortit elektronik të caktimit të relatorëve për pozicionet vakante në çdo institucion.

15. Nëpërmjet pajisjes elektronike të sistemit të administrimit të çështjeve programohet që, në çastin e ekzekutimit të veprimit teknik të shortit, për secilin pozicion vakant të secilit institucion që ka vënë në lëvizje Këshillin, të rezultojë anëtari i Këshillit që caktohet si relator për kryerjen e procedurave ligjore për verifikimin, vlerësimin dhe renditjen e kandidaturave përkatëse. Njëkohësisht, deri në ezaurimin e numrit të anëtarëve të Këshillit, sistemi i administrimit të çështjeve siguron që, në procesin e shortit elektronik, anëtari i Këshillit i shortuar si relator, përjashtohet nga zgjedhja në vijim me short e relatorëve për pozicionet e tjera vakante.

16. Nën drejtimin e Kryetarit të Këshillit, specialisti i IT, i vendosur pranë pajisjes elektronike të sistemit të administrimit të çështjeve, pasi shpjegon paraprakisht mënyrën e regjistrimit të të dhënave dhe të funksionimit të shortit elektronik, lexon me zë të lartë dhe tregon në mënyrë qartazi të dukshme përpara të gjithë të pranishmëve, sipas rastit, regjistrimin e secilit :

a) anëtar dhe anëtar zëvendësues të Këshillit në sistemin e menaxhimit të çështjeve të Gjykatës së Lartë;

b) pozicion vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese në secilin institucion kushtetues që ka vënë në lëvizje Këshillin e Emërimeve në Drejtësi;

c) kandidat për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese në secilin institucion kushtetues që ka vënë në lëvizje Këshillin e Emërimeve në Drejtësi;

ç) pozicionit vakant për Inspektor të Lartë të Drejtësisë;

d) kandidat për pozicionin vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

17. Pas leximit dhe verifikimit të saktësisë së të dhënave në pajisjen elektronike të sistemit të administrimit të çështjeve, Kryetari i Këshillit urdhëron zhvillimin e shortit elektronik për caktimin e relatorëve për pozicionet vakante në çdo institucion dhe specialisti IT ekzekuton veprimin teknik në pajisjen elektronike që realizon procesin e shortit.

18. Në përfundim të procesimit elektronik të veprimit të shortit, specialisti i IT lexon me zë të lartë rezultatin e nxjerrë nga sistemi elektronik për anëtarin përkatës të Këshillit të përzgjedhur si relator për secilin pozicion vakant në secilin institucion që ka vënë në lëvizje Këshillin. Njëkohësisht, specialisti i IT realizon edhe printimin e rezultatit të shortit elektronik në letër. Kryetari, anëtarët e Këshillit dhe pjesëmarrësit e tjerë në procedurën e shortit njihen me përmbajtjen e dokumentit të printuar që përmban rezultatin e shortit.

19. Në rastet kur, sipas rezultatit të shortit elektronik, rezulton të jetë caktuar si relator anëtari i Këshillit i dorëhequr apo përjashtuar nga pjesëmarrja në shqyrtimin e kandidaturave për shkak të gjendjes së papajtueshmërisë, konfliktit të interesit ose pengesës ligjore me një a më shumë kandidatë të atij pozicioni vakant, ai/ajo zëvendësohet automatikisht nga anëtari zëvendësues përkatës sipas ligjit.

20. Nëse për anëtarin e Këshillit të dorëhequr apo përjashtuar, nuk ka anëtar zëvendësues ose anëtari zëvendësues rezulton se është gjithashtu në kushtet e papajtueshmërisë, konfliktit të interesit apo të pengesës ligjore, procedura e shortit elektronik përsëritet, pa vonesë, ndërmjet anëtarëve të tjerë të Këshillit.

21. Dokumenti i printuar nga sistemi elektronik, ku përmbahen të dhënat e rezultatit të çdo procedure të shortit, nënshkruhet nga specialisti i IT dhe Kryetari i Këshillit dhe vendoset në

dokumentacionin përkatës të pozicionit vakant të caktuar për shqyrtim relatorit sipas shortit elektronik.

22. Në përfundim të procesit të shortit për të gjitha pozicionet vakante të shpallura nga çdo institucion që ka vënë në lëvizje Këshillin, Kryetari shpall rezultatin e shortit elektronik dhe deklaron mbylljen e procedurës për caktimin e relatorëve.

23. Kryetari kujdeset që, lidhur me dokumentimin e çdo faze të procedurës dhe veprimet e kryera për realizimin e shortit elektronik të mbahet procesverbal nga njëri prej punonjësve administrativ të Gjykatës së Lartë të caktuar për mbështetjen administrative të Këshillit. Procesverbali përmban:

- a) vendin, datën, kohën e fillimit dhe të përfundimit të procedurave të shortit;
- b) personat e pranishëm në procedurën e shortit dhe cilësia e tyre;
- c) pozicionin vakant për të cilën është vënë në lëvizje Këshilli dhe është realizuar shorti;
- ç) listën me emrat e kandidatëve për secilin pozicion vakant për të cilët realizohet shorti;
- d) veprimet që janë kryer në realizimin e shortit elektronik;
- dh) relatorin e caktuar nga shorti elektronik për secilin pozicion vakant.

24. Procesverbali i shortit elektronik, pasi nënshkruhet nga punonjësi i ngarkuar për mbajtjen e tij, anëtarët dhe anëtarët zëvendësues të Këshillit që kanë marrë pjesë në procedurën e shortit, vendoset në dokumentacionin përkatës të pozicionit vakant të caktuar për shqyrtim relatorit sipas shortit elektronik.

25. Procedura e zhvillimit të shortit elektronik regjistrohet në sistemin audio.

26. Rezultati i shortit elektronik për relatorin dhe procesverbali përkatës bëhet publik në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë.

IV. Procedura për caktimin e relatorëve përmes shortit manual

27. Nëse teknologjia e sistemit të administrimit të çështjeve të Gjykatës së Lartë nuk mund të realizojë procedurën e shortit në mënyrë elektronike, Këshilli vendos për zbatimin e procedurave të shortit në mënyrë manuale për caktimin e relatorëve për pozicionet vakante në çdo institucion.

28. Përveç kur parashikohet ndryshe në këtë Kre, për zhvillimin e procedurës së shortit në mënyrë manuale zbatohen rregullat e parashikuara për shortin në mënyrë elektronike.

29. Shorti manual organizohet me dy kuti transparente. Në njërin prej kutive vendosen goglat me emrat e secilit prej anëtarëve të Këshillit dhe në kutinë tjetër vendosen goglat me secilin nga pozicionet vakante të shpallura nga çdo institucion që ka vënë në lëvizje Këshillin. Numri total i goglave në secilën kuti duhet të përputhet saktësisht, përkatësisht me numrin e anëtarëve të Këshillit dhe me numrin e pozicioneve vakante.

30. Në praninë e të gjithë pjesëmarrësve, njëri prej punonjësve administrativ të Gjykatës së Lartë të caktuar për mbështetjen administrative të Këshillit, duke ia treguar pjesëmarrësve dhe lexuar me zë të lartë, kryen veprimet për vendosjen në secilën gogël të një shiriti letre

që përmban emrat e secilit prej anëtarëve të Këshillit, gogla të cilat vendosen bashkërisht në njërën prej kutive transparente.

31. Një punonjës tjetër administrativ i Gjykatës së Lartë i caktuar për mbështetjen administrative të Këshillit, i ndryshëm nga ai që tregohet në pikën 30 më sipër, duke ia treguar pjesëmarrësve dhe lexuar me zë të lartë, kryen veprimet për vendosjen në secilën gogël të një shiriti letre që përmban secilin pozicion vakant të shpallur nga çdo institucion që ka vënë në lëvizje Këshillin, gogla të cilat vendosen bashkërisht në kutinë tjetër transparente.

32. Në vijim, një punonjës i tretë administrativ i Gjykatës së Lartë i caktuar për mbështetjen administrative të Këshillit, kryen veprimin e tërheqjes së goglës nga kutia transparente që përmban pozicionet vakante të shpallura nga çdo institucion që ka vënë në lëvizje Këshillin. Pasi hap goglën, lexon me zë të lartë pozicionin vakant që përmban shiriti i letrës brenda saj dhe ia tregon të gjithë pjesëmarrësve në short. Shiriti i letrës që gjendet brenda goglës së tërhequr, i dorëzohet punonjësit që mban procesverbalin e shortit.

33. Pas këtij veprimi, punonjësi tjetër administrativ i Gjykatës së Lartë i caktuar për mbështetjen administrative të Këshillit, i ndryshëm nga të mëparshmit, kryen veprimin e tërheqjes së goglës nga kutia transparente që përmban emrat e secilit prej anëtarëve të Këshillit. Pasi hap goglën, lexon me zë të lartë emrin e anëtarit të Këshillit që përmban shiriti i letrës brenda saj dhe ia tregon të gjithë pjesëmarrësve në short. Shiriti i letrës që gjendet brenda goglës së tërhequr, i dorëzohet punonjësit që mban procesverbalin e shortit.

34. Anëtari i Këshillit që rezulton i shortuar sipas pikës 33 më sipër është relatori i caktuar për kryerjen e procedurave ligjore për verifikimin, vlerësimin dhe renditjen e kandidatave të pozicionit vakant të përzgjedhur me short sipas pikës 32 më sipër.

35. Në vijim, me të njëjtën procedurë, veprohet për caktimin e relatorit për secilin nga pozicionet vakante të shpallura nga çdo institucion që ka vënë në lëvizje Këshillin.

36. Në rastin kur numri i pozicioneve vakante që shortohen është më i madh se ai i anëtarëve të Këshillit, në përfundim të procesit të shortit për të gjithë anëtarët, procedura e parashikuar në këtë Kre rifillon për pozicionet vakante të mbetura pa i shortuar.

37. Në përfundim të procesit të shortit për të gjitha pozicionet vakante të shpallura nga çdo institucion që ka vënë në lëvizje Këshillin, Kryetari shpall rezultatet e shortit manual dhe deklaron mbylljen e procedurës për caktimin e relatorëve.

VI. Procedura për caktimin përmes shortit të ndihmësve ligjorë

38. Numri i nevojshëm i ndihmësve ligjorë caktohet paraprakisht nga Kryetari, pas këshillimit me anëtarët e Këshillit, në varësi të numrit të kandidatave për secilin pozicion vakant.

39. Ndihmësit ligjorë të relatorëve caktohen me short manual, në të njëjtën ditë, pas përfundimit të procedurës së shortit për caktimin e relatorëve ose, në çdo rast, në mbledhjen e Këshillit që zhvillohet jo më vonë se 5 ditë nga dita e publikimit të listës së kandidatëve, për pozicionin vakant në Gjykatën Kushtetuese nga subjekte që vënë në lëvizje Këshillin e Emërimeve në Drejtësi ose nga ajo e publikimit të listës së kandidatëve për Inspektor të Lartë të Drejtësisë nga ana e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

40. Procedura për caktimin me short të ndihmësve ligjorë realizohet duke zbatuar rregullat e parashikuara në Kreun IV të këtij Vendimi.

VII. Dispozita kalimtare dhe të fundit

41. Për vitin 2019, procedurat e shortit për caktimin e relatorëve për pozicionet vakante ekzistuese të shpallura nga çdo institucion që ka vënë në lëvizje Këshillin, do të zhvillohen jo më vonë se 3 ditë nga ajo e miratimit dhe hyrjes në fuqi të akteve nënligjore mbi procedurat e verifikimit të pasurisë, integritetit dhe të së shkuarës profesionale e personale të kandidatëve, si edhe për vlerësimin dhe renditjen e kandidatëve, sipas delegimit ligjor të pikës 2 të nenit 229 dhe të pikës 6 të nenit 240 të ligjit nr. 115/2016.

42. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Ardian Dvorani